



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
*Komisioni për Integrimin Europian*

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**

Datë 16.04.2015, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 07.04.2015.
2. Miratimi i kalendarit për periudhën 10-30 prill 2015.

**Marrin pjesë:**

Majlinda Bregu, Edi Paloka, Ilir Xhakolli, Taulant Balla, Bujar Derveni, Gramoz Ruçi, Sadri Abazi dhe Kejdi Mehmetaj.

**Mungojnë:**

Esmeralda Shkju, Arben Imami dhe Gerti Bogdani.

## HAPET MBLEDHJA

**Majlinda Bregu** – Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Pika e parë e rendit të ditës është procesverbali i mbledhjes së kaluar, për të cilin besoj se nuk kemi ndonjë problem, dhe programin e punës për periudhën 10-30 prill 2015.

Ne do t'i vazhdojmë seancat dhe parlamentin, pavarësisht fushatës zgjedhore, apo jo?

**Edi Paloka** – Mua po më pyet?

**Majlinda Bregu** – Të pyes ty, si kryetar të grupit tim parlamentar këtu.

**Edi Paloka** – Vendosin të tjerët, nuk vendos unë.

**Majlinda Bregu** – Mirë, shumë mirë!

**Edi Paloka** – Vendos shoku Ilir.

**Majlinda Bregu** – Atëherë, kemi projektligjin “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë” në datën 23, të cilin do ta bëjmë dhe, duke qenë se nuk kemi ligje të tjera në kalendar, unë them që të thërrasim dy ministra për seanca dëgjimore në komision, ministrin e Financave, sepse kemi pjesën e paketës së IPA-s, dhe sigurisht ministren e Integritetit Europian, pasi jemi para Këshillit, pas KSA-së së Komitetit, kohë pa ardhur ka...

**Taulant Balla** – Kë tjetër?

**Majlinda Bregu** – Edhe ministrin e Financave.

**Taulant Balla** – Mirë, të Financave. Po tjetër?

**Majlinda Bregu** – Edhe të Integritetit për këtë kalendar.

**Denis Gila** – Për çfarë do të vijë zonja Gjoshja, do të raportojë për...?

**Taulant Balla** – Raportim për procesin.

**Majlinda Bregu** – Raportim.

Së pari, është bërë ligji, ka KSA-në, jemi para Këshillit të Stabilizim-Asociimit. Pra, kanë gjëra për të folur.

**Taulant Balla** – Formuloje me pika dhe ta firmosë kryetarja.

**Majlinda Bregu** – Për të dy ministrat.

**Denis Gila** – Datat i vendosni vetë?

**Majlinda Bregu** – I shohim në këtë kalendar.

Ti, Edi, ke ndonjë propozim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk ke.

**Majlinda Bregu** – Faleminderit për pjesëmarrjen!

**MBYLLET MBLEDHJA**

**Kryetare**  
**Majlinda Bregu**

**Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**